



Papunësia

Të gjithë të punësuarit të cilët banojnë në Zvicër, janë të siguar kundër papunësisë. Kush mbetet i papunë, merr sipas rregullit përgjatë një kohe të caktuar mbështetje financiare. Të papunët duhet të lajmërohen në qendrat rajonale ndërmjetësuese për punë (RAV | ORP). Kjo ju ndimon përgjatë kërkimit të një pune.

Sigurimi i të papunëve

Sigurimi i të papunëve (ALV | AC) është një sigurim shtetëror dhe për të gjithë të punësuarit i detyrueshëm. Shumat mujore zbriten direkt nga rroga, punëdhënësi merr gjysmën përsipër. Të pavarurit nuk mundën të sigurohen te sigurimi i të papunëve. Kush mbet pa punë, merr prej një kase për të papunët një pagë mujore zëvendësuese para për të papunët, (Arbeitslosengeld | allocation chômage). Nëse, kur, dhe në çfarë shume paguhen parat për të papunët, mvaret prej shumë faktorëve. Për shembull, sa gjatë ka punuar njeriu, apo për çfarë arsye ka mbetur i pa punë.

Veprimi gjatë papunësisë

Kush mbetet pa punë, duhet sa më shpejt që është e mundur të lajmërohet në komunën ku banon. Ideale është këtë e bënë njeriu para ditës të fundit të punës, më s'voni në ditën e parë të papunësisë. Paralelisht duhet patjetër të lajmërohet njeriu te qendra përkatëse rajonale për ndërmjetësim për punë (RAV | ORP). Aty ju sqarohet e gjithë procedura.

Qendra rajonale e ndërmjetësimit për punë

Qendra rajonale e ndërmjetësimit për punë (RAV | ORP) ndihmon në atë, për ta gjetë përsëri shpejt një punë. Bisedat këshilluese në RAV | ORP janë të detyrueshme, kur njeriu tërheq para për të papunët. RAV | ORP ofron edhe kurse dhe programe për veprimtari. Këto janë pjesërisht po ashtu të detyrueshme. Edhe personat, që kurr nuk kanë punuar në Zvicër dhe kërkoj një punë, mundën të lajmërohen në RAV | ORP. Mirëpo ata nuk marrin para.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/siguria-sociale/papunesia